



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSOR PRIVAT  
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "DORIAN SKËNDI"

Adresa: Rr. "Ymer Kurti", Qendra Olimpia, Kati II, mbrapa Postes Nr.8, Tiranë Mob.0692777006



ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT  
"DORIAN SKËNDI"  
NIPT L31902009K

Nr.539.Prot  
Nr.218/2021.Dosje

Tiranë më datë 22/07/2021

**Lënda:** Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative mbi kuotat e shoqërisë.

**Drejtuar:** Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)

Tiranë

**Për dijeni:** Shoqëria "SHKODRA BETON-INERT" shpk

Tiranë

Pranë Zyrës së Përmbartimit Privat "Dorian Skëndi", me kërkesë të palës kreditore është rregjistruar çështja përmbartimore me numër 218/2020 në zbatim të titullit ekzekutiv, Fatura Tatimore Shitje me nr.serial 84211517 datë 10.12.2019; etj,, për të cilat është lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Urdhëri i Ekzekutimit Nr.1238.Regj.Them datë 21.05.2021.

Palës debitore i është dërguar lajmërimi për ekzekutim vullnetar Nr.506.Prot dt.07.07.2021, për të cilin ka marrë dijeni dhe nuk ka shlyer detyrimin brenda afatit vullnetar. Me vendimin Nr.537.Prot dt.22.07.2021 është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për të bërë të mundur ekzekutimin e titullit duhet urdhëruar vendosja e sekuestros konservative mbi kuotat e palës debitore.

**Për këto arsye**, si dhe në bazë të neneve 519,527 të K.Pr.Civile dhe ligjit Nr.26/2019 datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat", **Urdhëroj:**

1- Vendosjen e sekuestros konservative deri në një urdhër të dytë mbi kuotat e rregjistruara të debitorit:

- Shoqëria "SHKODRA BETON-INERT" shpk me Nipt L72025009M dhe me administrator znj.Mukadez Gjini.

2-Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3-Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri, do të merren të gjitha masat e parashikuara në K.Pr.Civile si dhe në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

4-Ky urdhër u njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C, kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT  
DORIAN SKËNDI

